



REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS	OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHTËRPCËS
01/P- Prot.	IZLAZNI - DALESE
4/P-prot.	01-020/08-1178118
Grastr.	1
Nr.i fq.	
Datum	31.01.2018.
Data	ŠTRPCE - SHTËRPCË



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpcce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce

Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës Nr. 01- 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 29/01/2018 miratoi këtë :

V E N D I M

Miraton procesverbal nga seanca e kuvendit e mbajtur me 14.12.2017


1. Miratohet procesverbal nga seanca e kaluar e Kuvendit i Komunës sipas tekstit e dhënë në këtë vendim.

2. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit te Kuvendit Komunal .

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic





IZLAZNI - DAI FSE
07-020108-117818

Br.Pot.
Br.str.
Nr.i fq.
Datum
Data

6
31.01.2018.



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpcë
Komuna e Shtërpçës
Municipality of Strpce

PROCESVERBAL

Nga seanca e inauguruese të Kuvendit të Komunës së Shtërpçës, e mbajtur më datën:
14.12.2017, me fillim në ora 10,

Rendi i ditës:

1. Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë.
 2. Fjala mirëseardhëse e Anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës (Kryesues i mbledhjes).
 3. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.
 4. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës.
 5. Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës.
 6. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit te komunës
 7. Zgjedhja e zëvendësit e kryesuesit për komunitete.
 8. Fjala përshëndetëse e kryesuesit të kuvendit të komunës.
 9. Mbyllja e seancës
-
2. Fjala mirëseardhëse e Anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës (Kryesues i mbledhjes).

Dragomir Stanisavljevic: Të nderuar kryetar i komunës, të respektuar koleg këshilltar, të respektuar zëvendësi i kryeministrit ministri për komunitete dhe kthim, të nderuar zëvendësit e ministrit, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të gjithë të tjerë të pranishëm, mirë së vini në seancën inauguruese të KK Shtërpçës. Në seancën e sotme e inaugurimit e marrin pjesë të gjithë 15 këshilltar, që do të thotë se kemi kuorum dhe mundemi të fillojmë me punë. Në bazë të nenit 42.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, unë, Dragomir Stanisavljevic, jam kryesues i kësaj seancës së inauguruese, si anëtari më i vjetër i Kuvendit deri sa të zgjidhet kryesuesi i KK Shtërpçë.

3. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Dragomir Stanisavljevic: E lus këshilltar që ngriten në këmbë dhe unë do të lexoj betimin në emër të gjithëve, të cilin do të nënshkruan pas përfundimit e leximit të betimit.

UNË, DRAGOMIR STANISAVLJEVIC, „BETOHEM SE ME NDER, BESNIKËRI, PA ANIME, ME NDERGJEGJE DHE SIPAS LIGJIT DO T'I KRYEJ DETYRAT TË MIA DHE DO TË USHTROJ AUTORIZIMET E MIA SI KËSHILLTAR I KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTËRPCË NË MENYR QË TË SIGUROHEN KUSHTET PËR JETË TË QETË PËR TË GJITHË QYTETARET”

4. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës.

Dragomir Stanisavljevic: E lus kryetarin e zgjedhur z. Bratislav Nikolic që të jep betim, Kryesuesi i seancës ka falënderuar kryetarin për dhënie e betimit dhe ka shfrytëzuar rastin që ja uron mandatin e ri dhe i ka uruar shumë sukses në punën e mëtejshme.

Kryetari i komunës pas dhënes së betimit ju ka drejtua të pranishmëve:

„Qytetarë të respektuar të komunës së Shtërpcës, të respektuari kryesuesi, të respektuari zëvendësi i kryeministrit Jeftic, të respektuari këshilltar, dhe të tjerë my safir, përfaqësuesit e mediet, zonjat dhe zotëri.

Sot po fillon një fazë e re e shkrimit të historisë së komunës së tonë, sot këtu para jush dua të them që në meny shumë konkrete, e jepi një porosi, që në Shtërpce edhe në vazhdim do të mbahet fjala e dhanë dhe unë ju kam dhen fjalë në vitin 2009 dhe 2013 që Shtërpce çdo dit do të behet një vend më i mirë për jetë e të gjithë qytetarëve. Kam dhen fjalë që ndarje mes nesh do të jetë e kaluara dhe që të gjithë si një do të punojmë së bashku për prosperitet dhe një jetë më të mirë, për çdo qytetar. Jam krenar më faktin që gati më një zër jam zgjedhur për kryetarin e komunës së Shtërpcës.

Sa shumë jam krenar, jam edhe vetëdijshëm për përgjegjësi më të madhe që tani e kam, përgjegjësin të cilën unë e marr më qartësi dhe për ata obligohem, këtu para juve sot që do të vazhdoj të punoj së bashku me juve që Shtërpce nesër dhe çdo dit bëhet vendi më i mirë dhe më i bukur.

Në katër vitet e ardhshme, theksimi i veçantë në punën e vetëqeverisjes lokale do të jetë zhvillimi i ekonomisë, bujqësisë dhe turizmit. Ne do të vazhdojmë me zhvillimin dhe kultivimin e mjedrës, së shpejti do të fillojmë një projekt i madh për ndërtimin e sistemeve të ujitjes, me qëllim të sjelljes së ujit në çdo fushë. Ne do të vazhdojmë të ndihmojmë fermerët tanë, me subvencione, që të mbështetim qytetarët tanë punëtor dhe në këtë mënyrë dhe t'u sigurojmë atyre mundësinë për të marrë makineri dhe të miellin mjedër dhe gjithçka që do t'i ndihmojë atyre, që në fillimin e kultivit e mjedrës me investime minimale të fillojnë me prodhim.

Komuna e Shtërpcës do të propozon një zgjidhje ekonomike dhe qëndrueshme për ski-qendër Brezovicë. Nuk ka më kohë për të pritur, ka ardhur momenti që na si qeverisja lokale të marrim

gjithë përgjegjësi për këtë çështje dhe ne fund me parimin „partneriteti publiko privat” përfundimisht të zgjidhmi çështje e Brezovicës. Do të përdor pozitën time dhe marrëdhënie time të shkëlqyer me Beogradin dhe Prishtinën, si dhe me Bashkësinë Ndërkombëtare dhe do t'u kërkoj atyre që të mbështesin propozimin që ne, si një vetëqeverisje lokale, do të japi. Në fund Brezovicën askush nuk mund të zhvendos as në Beograd as në Prishtinë, as në Bruksel, Moskë ose Uashington. Brezovica është këtu, dhe së bashku me një investitor serioz strategjik Brezovica mund të bohet krenaria e të gjithëve atyre që jetojnë këtu, por edhe atyre që vinë në Brezovic.

Me zhvillimin e turizmit do të zhvillohet edhe ekonomia, ato janë e lidhur ngushtë njëra më tjetrën, nga prodhimi i ushqimit të shëndetshëm dhe plasmanit e produkteve vendore deri të zhvillimin e tregtisë, çdo familje që jeton në Komunën e Shtërpcës do të këtë mundësi që të punojë dhe të fitojë nga puna e tyre.

Arsimi është një segment i rëndësishëm të cilit do t'i përkushtohemi, fëmijët tanë janë e ardhmja jonë dhe ne do të punojmë në të ardhmen, në përmirësimin e kushteve në institucionet tonë arsimore. Disa gjëra tashmë janë bërë, por shumica e asaj që është planifikuar do të bëhet në muajt në vijim.

Një theks i veçantë në punën e vetëqeverisjes lokale do të jetë zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës, si dhe mirëmbajtja e saj. Do të përmirësojmë sektorin e shërbimeve publike dhe prioriteti do të jetë mbrojtja e mjedisit, uji të pijshëm të shëndetshëm dhe rregullimi i hapësirave publike. Në këtë pjesë veçanërisht kisha ftuar të gjithë bashkëqytetarët tanë që të na ndihmojnë për këtë. Ne do të forcojmë punën e shërbimeve të inspektimit dhe do të ndëshkojmë të gjithë qytetarët e pandërgjegjshëm. Ne në ana tjetër po planifikojmë t'i shpërblejmë njerëz që janë të ndërgjegjshëm.

Nga projektet më të rëndësishme të cilin unë dua të theksoj me krenari, është vazhdimi e ndërtimeve dhe renovimeve e shtëpive në komunën e Shtërpcës. Mbijetesa dhe qëndrimi do të jetë prioriteti ynë dhe në këtë mënyrë unë dëshiroj të falënderoj Ministrinë për Kthim dhe Komunitete përfaktin se Shtërpce do të vazhdojë të jetë pjesë të projektit e RRK, por edhe të zgjidhmi përfundimisht çështjen e qendrave kolektive, dhe për të gjitha familjet që jetojnë në kushte çnjerëzore në fund e bëjmë një zgjidhje të qëndrueshme, pas pothuajse dy dekadave të qëndrimit në qendrat kolektive në Brezovicë. Falënderoj ministrisë dhe falënderoj Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, IOM, Këshilli Danez përf Refugjatë dhe të gjithë ata që na ndihmojnë përf realizimin e këtyre projekteve.

Nuk duhet të tregoj veçantë të gjithëve, se sa përf të gjitha që deri tanë kam thënë, se është më e rëndësishme që të kemi një situatë të qëndrueshme dhe sigurt në komunën tonë. Jam krenar përf faktin se ne jemi shembull përf multietnitet në Kosovë dhe jo vetëm në Kosovë, ne jemi një shembull përf të gjithë Ballkanin.

Sigurisht kjo nuk do të thotë se nuk ka rreziqe të tjera dhe elementet që mund të ndikojnë në stabilitet dhe sigurinë në komunën tonë, dhe kjo është arsyja pse ne si pushtet lokal së

bashku me organet e sigurisë në komunën e Shtërpcës, do të punojmë që të eliminojmë çdo rrezik, që gjithë qytetarët të ndihen të sigurt dhe veçanërisht fëmijët tonë.

Kryetari i komunës pastaj u drejtar në gjuhën shqipe:

Serbët dhe shqiptarët në Komunën e Shtërpcës kanë rëndësi të njëjtën dhe bashkëpunimi ynë brenda qeverisë lokale do të vazhdojë me punën e përbashkët në ndërtimin e besimit dhe respektit reciprok. Do të respektohet drejta e të gjithëve, pavarësisht nga kombësia e qytetarëve të komunës së Shtërpcës.

Suç kam theksuar shumë here, unë isha dhe do të jem kryetari i komunës për të gjithë qytetarët e Komunës së Shtërpcës.

Të nderuar deputetë,
Detyra e juaj është që të justifikoni besimin e qytetarëve, që këtu në kuvendin lokal punoni për zhvillimin e komunës dhe shoqërisë sonë, për të mbështetur gjithçka që mendoni se është e mirë për ne, që jetojmë në komunën e Shtërpcës. Unë veçanërisht po drejtohem këshilltarëve e Listës Serbe – nga ju kërkoj që të flisni me qytetarët për dit, sepse vetëm ashtu ju do të jeni në gjendje të përfaqësoni interesat e tyre.

Detyrat e juaj, do të janë që të ndihmoni në përcaktimin e prioriteteve, dhe imja si kryetar që të punoj me të gjithë ju, në implementimin sa më të mirë të asaj që do të sjellë të mira për të gjithë ne. Ne duhet të jemi të gjithë së bashku efikas dhe produktiv në punën tonë.

Të nderuar qytetarë të komunës së Shtërpcës,
Suç keni vërejtur as sot, unë nuk kam folur për temat të larta politike. Nuk kam fol as sot si nuk kam fol kurrë, sepse puna ime është që të merrem me problemet lokale. Pikërisht për ata nga fillimi i punës time si kryetari, merrem me jetën e neve të cilit jetojmë këtu në Zhupën e Sirinjës së bukur, tani komuna e Shtërpcës është vendi më i mirë për jetë për të gjithë qytetarët.

Pikërisht për ata se nuk jam marr më drejtat dhe padrejtësi botërore, sot ne kemi respektin e të gjithëve - dhe Beogradit dhe Prishtinës dhe Komuniteti Ndërkombëtar. Nëse dikush mendon se është e lehtë të arrihet e gjithë kjo, besoni se nuk është. Ajo që kemi sot është rezultat i një politike të mençur dhe të guximshme.

Në fund ju jap fjalën time se Komuna e Shtërpcës do të zhvillohet, dhe të gjitha që ka treguar sot do të realizohen në tërësi, unë e japi fjalën time që pushteti lokal do të jetë në shërbimin tuaj, ne të gjithë do të punojmë së bashku për të zhvilluar dhe për të krijuar kushtet më të mira për jetesën në komunën tonë. Unë jap fjalën, dhe ju e dini shumë mirë që ato që unë premtoj do të plotësoj në tërësi.

Ju uroj një fillim të ri dhe të lumtur të punës së vetëqeverisjes lokale, ju uroj të gjithëve Vitin e Ri dhe festat e ardhshme. Dhe uroj të gjithë shëndetin dhe fatin e mirë, dhe neve si një qeveri ekzekutive ashtu edhe në Kuvend e porositi – që të punojmë më shpejtë, më të fortë, dhe më të mirë në përmbrushjen e qëllimeve të paraparë.

Faleminderit.

6. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit te komunës

Dragomir Stanisavljevic: E kërkoj nga këshilltar që të paraqesin propozimet e tyre për zgjedhje e kandidateve për kryesuesin e KK Shterpce

Sasa Krstic: Për kryesuesin e KK Shterpce e propozoj Predrag Gbicin

Sonja Kuzmanovic: Për kryesuesin e KK Shterpce e propozoj Radojken Repinovic

Dimitrije Stanisavljevic: Pasi e kemi dy kandidat për kryesuesin e kuvendit KK Shterpçës duhet të formojmë komisionin nga tre anëtaresh për numërimin dhe verifikimin e votave për kryesuesin e kuvendit. Tani e kërkoj nga këshilltaret që e propozojnë kandidatet për të formuar komision. Unë si kryesuesi kisha propozuar, për ata që përbajtja e komunës së tonë është multietike që dy kandidat janë nga komunitet serbë edhe një nga komuniteti shqiptar.

Miroslav Djordjevic: Unë e propozoj Srdjan Kosticin

Ragip Sahiti: Unë propozoj Rifat Rustemin

Vesna Samardjic: Unë kisha propozuar Ana Samardzicin

Konstatoj që komisioni u formua. Tani jepi një pauzë, derisa administrata përgatit fletët të votimit për votim.

Seanca vazhdon me punë pas pushimit.

Dimitrije Stanisavljevic: Kërkoj nga komisioni që të numëron fletët e votimit. Në rregull është, komisioni ka konstatuar që ka 15 fletët të votimi. Unë do të ftoj këshilltaret që të shkijnë deri të komisioni dhe të marrin fletët dhe të nënshkruan që kanë marr fletët të votimit, Komisioni ka konstatuar së të gjitha fletët e votimit janë vlefshme dhe kanë nisur me numërimin e votave. Rezultati i votimit është:

Predrag Grbic	15 vota
Radojka Repinovic	0 vota

Ana Milosavljevic: Komisioni ka verifikuar që për kryesuesin e KK Shterpçës u zgjedhur Predrag Grbic dhe na ja urojmë.

Dimitrije Stanisavljevic: Urime për ju z. Grbic në zgjedhje për kryesuesin e Kuvendit, ju dorëzoj funksionin e kryesuesit dhe ja uroj shumë suksese në punën e mëtejshme.

Predrag Grbic: Të respektuari kryetar i komunës, të respektuar koleg këshilltar, të respektuari zëvendësi i kryeministrat- ministri për komunitete dhe kthim, të respektuari përfaqësuesi i kryetarit e Kosovës, të respektuari zëvendësit e ministrit, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe të gjithë të tjera të pranishëm, mirë dita. Unë kam dashur më tregu shumë gjera, por pas këtij rezultatit, unë jam pak i hutur. Unë kisha uruar kryetarin z. Bratislav Nikolicin, për fitoren në zgjedhje e fundit, për kryetarin e komunës. Ju uroj shumë suksese në të ardhmen, dëshiroj që të keni sukses në realizimin e të gjithë qëllimeve të parashikuar dhe planeve të cilat e keni prezantuar, ne e dimë, që ju e mbani fjalën, dhe unë si kryesuesi i kuvendit po ju jepi përkrahje e plot si deri tani. Shpresoj që puna ime e shkëlqyer në mandatin e fundit kur kam udhëhequr Kuvendin ka kontribu në atë që jam zgjedhur unanimisht për kryesuesin e Kuvendit. Unë kam obligimin e madh, dhe do të jeni sigurt që punën e kryesuesit do të krye në

përputhje me ligjin të cili është i lidhur me punën e Kuvendit. Tani kisha kaluar në pikën e ardhshme e rendit të ditës.

7. Zgjedhja e zëvendësit e kryesuesit për komunitete.

Predrag Grbic: Siç e dini në ligjin për qeverisje lokale në nenin 61. thuhet së në komunat ku së paku 10% popullit e përkasin komunitetit që nuk është shumica, në ato vende, vendi i zëvendësit e kryesuesit për komunitet është rezervuar për këta komunitete, në këtë rast ata jonë komunitet shqiptar. Megjithatë, në nenin 54.2. ligjit për vetëqeverisje lokale thotë që vendi i zëvendësit kryesuesit KK Shterpce për komunitete i takon kandidatit nga komunitetit pakicë i cili ka marr mëshomë vota në listën e kandidateve për zgjedhje e Kuvendit e Komunal. Në kemi pasur një situatën pakënaqshme që dy listat të cilat janë kandiduar në këto zgjedhje e kishin numrin e barabartë votave, që është 949 vota. Më keqardhje në ligjin për vetëqeverisje lokale nuk kanë dhen zgjidhje për këtë situatë nuk është parashikuar, ashtu që as unë si kryesuesi nuk kisha dashur që zgjidhje e kësaj situatës e marr sipër meje, ose të zgjidhi në bashkëpunimin më këshilltar. Ne jemi drejtuar ministrisë së administratës të vetëqeverisjes lokale për ndihmë, që ata na japid udhëzimin, si të zgjidhmi këtë situatën. Unë si kryesuesi i respektoj drejtën e të gjithë qytetareve pa dallime të cilës partisë e përkasin ose përkatësi tjeter, dhe për ata si kryesuesi i cili respekton ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe i cili ka parime e tillë, kjo pikë unë nuk do të zgjatet sot, më keqardhje do të presim interpretimin nga MPL-e. Kuvendi i ardhshëm do të caktohet në mes të janarit dhe presim që deri tani do të marrim udhëzime për të zgjidhur këtë situatë. Pasi që nuk kemi më ndonjë gjë të paraparë për Kuvendin e sotëm, ju falënderoj të gjithë në pjesëmarrjen, seanca sotme e inauguruese ka përfunduar.

Procesmbajtësi
Staja Markovic



Kryesuesi i K.K.
Predrag Grbic